



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇËSHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE**

Nr. 236 prot.

Tiranë, më 27.01.2021

U R D H Ë R

Nr. 14, datë 27.01.2021

**"PËR
MËNYRËN E RAPORTIMIT DHE MONITORIMIT TË PLANIT STRATEGJIK
DHE PLANIT TË VEPRIMIT TË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË"**

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, nenit 204, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 115/2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", të ndryshuar dhe në përputhje me kreun V të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit 2020-2022 për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, miratuar me urdhrin nr. 106, datë 01.12.2020 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë "Për miratimin e planit strategjik dhe planit të veprimit, për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2020-2021",

U R D H Ë R O J:

1. Përcaktimin e mënyrës së raportimit dhe monitorimit të Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit 2020-2022 për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Sektori i raportimit dhe përfaqësimit, në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, është struktura përgjegjëse për monitorimin e Planit Strategjik dhe Planit të Veprimit 2020-2022 për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
3. Në funksion të monitorimit, Sektori i Raportimit dhe Përfaqësimit ka këto detyra:
 - a. U kërkon titullarëve të strukturave përgjegjëse të përcaktuar në planin e veprimit, përcjelljen e informacioneve në përputhje me masat/aktivitetet e parashikuara brenda datës 5 të çdo tremujori pasardhës;
 - b. Koordinon, mbledh dhe përpunon informacionin e ardhur nga të gjitha strukturat e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
 - c. Harton raporte tre mujore të përmbledhura monitorimi bazuar mbi kontributet e përcjella në zbatimin e planit strategjik dhe planit të saj të veprimit, si dhe shkallën e arritjes së indikatorëve sipas afateve të maturimit;
 - d. Publikon raportet e përgatitura në kuadër të transparencës së veprimtarisë institucionale.

4. Çdo strukturë pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë brenda datës 5 të tremujorit pasardhës, raporton pranë Sektorit të Raportimit dhe Përfaqësimit mbi nivelin e zbatimit të secilit aktivitet/masë sipas fushës së veprimtarisë së secilës njësi organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Mënyra e raportimit bëhet sipas aneksit nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
5. Sektori i Raportimit dhe Përfaqësimit brenda datës 10 të çdo tremujori pasardhës harton raportin tremujor mbi nivelin e zbatimit të secilit aktivitet/masë, si dhe nivelin e përmbushjes së objektivave dhe e dorëzon atë pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
6. Në përfundim të afatit të strategjisë, do të hartohet një raport vlerësimi lidhur jo vetëm me zbatimin e strategjisë gjatë gjithë periudhës së kohëzgjatjes së saj, por edhe lidhur me impaktin që strategjia ka pasur për arritjen e objektivave, vizionit të strategjisë dhe problematikave të evidentuara në përmbushje të masave/aktiviteteve. Në raport do të pasqyrohet shkalla e arritjes së indikatorëve vit pas viti.
7. Raportimi periodik i monitorimit mbi zbatimin e strategjisë dhe planit të saj të veprimit dhe shkallën e arritjes së treguesve (sipas afateve të maturimit), si dhe raporti i vlerësimit botohen në faqen zyrtare të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
8. Ngarkohen të gjitha strukturat e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me zbatimin e këtij urdhri.
9. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij urdhri, në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani



Aneks nr. 1 "Për mënyrën e raportimit të planit të veprimit 2020-2022"

Raportim për Planin e Veprimit 2020 -2022

Nr. Aktivitet	Detajimi i aktivitetit	Struktura raportuese/ përgjegjëse	Data e fillimit	Data e mbarimit	Mënyra e matjes/reqyesi i realizimit të aktivitetit	Ecuria e zbatimit të aktivitetit për periudhën _____
---------------	------------------------	--------------------------------------	-----------------	-----------------	---	--

Objektivi Strategjik:

Objektivi Specific:

Aktiviteti: